

Kodi i sjelljes dhe plani i sigurisë në të gjithë distriktin

Departamenti i Arsimit të Nju-Jorkut (DOE) është i përkushtuar të sigurojë që shkollat tona të jenë mjedise të sigurta, të mbrojtura dhe të rregullta, ku nxënësit mund të arrijnë standarde të larta akademike, mësuesit mund të japin mësim drejt atyre synimeve, dhe prindërit të jenë të sigurt që fëmijët e tyre po mësojnë në një ambient shkollor të sigurt dhe pozitiv. Një shkollë e sigurt dhe mbështetëse varet nga përpjekjet e të gjithë anëtarëve të komunitetit shkollor për ta trajtuar njëri-tjetrin me respekt të ndërsjellë.

Ligji i shtetit kërkon që DOE të zhvillojë një plan sigurie në të gjithë distriktin që trajton menaxhimin e emergjencave dhe ndërhyrjen në raste krize, si dhe një kod sjelljeje që rregullon sjelljen e nxënësve. Përveç kësaj, çdo shkollë është e detyruar të zhvillojë një plan sigurie në nivel ndërtese, i cili përcakton procedurat e sigurisë së godinës, duke përfshirë kontrollin e vizitorëve, evakuimin e nxënësve dhe procedura të tjera emergjente specifike për shkollën.

Kodi i sjelljes dhe plani i sigurisë në shkallë distrikti pasqyron kontributin dhe rekomandimet e ekipit të sigurisë në shkallë distrikti, përbërja e të cilit përshkruhet më poshtë.

Pikat kryesore të kodit të sjelljes dhe planit të sigurisë në të gjithë distriktin të DOE paraqiten më poshtë. Informacion shtesë gjendet në Rregulloret e Kancelarit (Chancellor's Regulations) dhe dokumente të tjera rregullore të përmendura në fund të këtij dokumenti.

1 - Plani i sigurisë shkollore në të gjithë distriktin

Ky Plan përfshin rregulloret dhe procedurat e DOE për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe të rregullt për të mësuarit. Plani përfshin rregullore dhe procedura për: reagimin ndaj akteve të dhunës ose aktiviteteve të tjera kriminale; kontaktimin dhe njoftimin e prindërve; dhe kontaktimin dhe njoftimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Plani gjithashtu trajton: strategjitë për të zbuluar sjellje potencialisht të dhunshme; strategjitë e ndërhyrjes dhe parandalimit; strategjitë për të përmirësuar komunikimin mes nxënësve dhe mes nxënësve e stafit shkollor; ~~rolin~~ [rolin](#) dhe përgjegjësitë e personelit të sigurisë së shkollës; trajnimin e personelit të sigurisë së shkollës; sigurinë e godinës shkollore dhe pajisjet e sigurisë; protokollet e reagimit emergjent; trajnimin për sigurinë për stafin dhe nxënësit, përfshirë trajnimin mbi protokollet e reagimit emergjent; dhe ushtrimet praktike për të testuar këto protokolle dhe komponentë të tjerë të Planit.

DOE punëson një Shef të Emergjencave (Chief Emergency Officer), dhe një Zëvendës për të shërbyer në mungesë të Shefit të Emergjencave. Shefi i Emergjencave është përgjegjës për koordinimin e: komunikimit mes stafit dhe zbatuesve të ligjit dhe shërbimeve të emergjencës; shqyrtimin dhe përditësimin vjetor të planit të sigurisë në të gjithë distriktin; përfundimin e planeve të sigurisë së shkollës, përfshirë planet e reagimit emergjent, të cilat janë të harmonizuara dhe në përputhje me planin e sigurisë në të gjithë distriktin; sigurinë e godinave dhe teknologjinë; trajnimin për siguri, mbrojtje dhe emergjenca për stafin dhe nxënësit; dhe trajnimet e reagimit emergjent.

Plani i sigurisë në të gjithë distriktin shqyrtohet çdo vit nga Shefi i Emergjencave së bashku me Ekipin e Sigurisë në Shkallë Distrikti. Shefi i Emergjencave është Mark Rampersant. ~~Në mungesë të tij, kjo detyrë do të kryhet nga Jay Findling.~~

Ekipi i sigurisë në të gjithë distriktin:

Ekipi [i sigurisë](#) në të gjithë distriktin përfshin përfaqësues nga agjenci dhe divizione të ndryshme të DOE, duke përfshirë:

- Paneli për Rregulloret e Arsimit (Panel on Education Policy – PEP)
- Federata e Bashkuar e Mësuesve (United Federation of Teachers – UFT)
- Këshilli i Mbikëqyrësve dhe Administratorëve (Council of Supervisors and Administrators – CSA)
- Zyra e DOE për Fuqizimin e Familjes dhe Komunitetit (Office of Family and Community Empowerment – FACE)
- Menaxhimi i Emergjencave të Qytetit të Nju Jorkut (New York City Emergency Management – NYCEM)
- Departamenti i Policisë së Qytetit të Nju-Jorkut (NYPD) - Divizioni i Sigurisë Shkollore (School Safety Division) - në Shkolla (SSD)
- FDNY
- Departamenti i Zjarrfikësve të Qytetit të Nju-Jorkut (FDNY)
- Zyra e Kancelarit të DOE për Sigurinë dhe Partneritetet e Parandalimit (Chancellor’s Office of Safety and Prevention Partnerships – OSPP)
- Zyra e DOE për Sigurinë dhe Zhvillimin e Rinisë (Office of Safety and Youth Development – OSYD)
- Divizioni i DOE për Objektet Shkollore (Division of School Facilities – DSF)
- Zyra e DOE për Planifikimin dhe Reagimin ndaj Emergjencave (Office of Emergency Planning and Response)
- Zyra e DOE për Shëndetin Shkollor (Office of School Health – OSH)
- Zyra e DOE për Shërbimet Ligjore (Office of Legal Services – OLS)
- Zyra e DOE për Transportin e Nxënësve (Office of Pupil Transportation – OPT)
- Departamenti i Shëndetit dhe Higjienës Mendore i Qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Health and Mental Hygiene – DOHMH)

a) Protokollet e Përgjithshme të Reagimit (General Response Protocols – GRP):

Më poshtë janë protokollet e reagimit emergjent që shkollat duhet të ndjekin për të kryer izolime (lockdown), evakuime, pritje (hold) dhe strehim (shelter-in). Çdo protokoll ka veprime specifike të stafit dhe nxënësve që janë unike për secilin rast. Këto janë veprimet që shkollat ndërmarrin deri sa të mbërrijnë shërbimet e emergjencës. Për të katër protokollet, duhet të thirret 911. Nëse drejtori ose i ngarkuari prej tij nuk e ka bërë telefonatën, ata duhet të njoftohen menjëherë që thirrja është kryer, në përputhje me Rregulloren e Kancelarit A-412 (Chancellor’s Regulation A-412), e cila përcakton rregulloret dhe procedurat për kontaktimin e Departamentit të Policisë së Qytetit të Nju Jorkut (NYPD) - së dhe 911 (shihni dokumentet kryesore më poshtë).

Departamenti i Arsimit i Qytetit të Nju Jorkut (DOE) dhe Divizioni i Sigurisë Shkollore i NYPD DOE dhe NYPD SSD krijuan këto protokolle për t’u mundësuar shkollave të reagojnë menjëherë dhe në mënyrë të sigurt ndaj llojeve të ndryshme të emergjencave që mund të ndodhin si brenda shkollave, ashtu edhe në komunitetin përreth. GRP përgatit shkollat për situata emergjente si zjarr, persona të paautorizuar brenda shkollës, sulmues aktivë në shkollë, ose kushte të rrezikshme jashtë ndërtesës së shkollës. Këto protokolle përshkruajnë reagimin reagimet e menjëhershëm menjëhershme që stafi i shkollës dhe nxënësit do të ndërmarrin deri në mbërritjen e shërbimeve të emergjencës.

Në të gjitha situatat emergjente, është shumë e rëndësishme vetëdija ndaj situatës, në mënyrë që të rriturit dhe nxënësit të marrin vendimin më të mirë për të qëndruar të sigurt.

Izolim - I Lehtë/Rëndë (Lockdown – Soft/Hard)

Izolimi i Lehtë nënkupton që nuk ka rrezik të menjëhershëm të identifikuar për ekipet e kontrollit (sweep teams). Në këtë rast, ekipet administrative, Ekipet e Reagimit të Godinës (Building Response Teams), dhe Agjentët e Sigurisë Shkollore të NYPD (School Safety Agents – SSA) do të mobilizohen në pikën e komandës së përcaktuar për udhëzime të mëtejshme.

Izolimi i Rëndë (Hard Lockdown) nënkupton që ekziston rreziku i menjëhershëm injohur, dhe ASKUSH nuk kryen kontroll të godinës. Kjo përfshin reagimin ndaj një incidenti me kërcënim aktiv.

Do të shpallet njoftimi sa vijon: “Attention (Vëmendje): We are now in a [Soft/Hard] Lockdown (Tani jemi në një izolim të lehtë/izolim të rëndë). Take proper action (Merrni masat e duhura).” (Ky njoftim përsëritet dy herë përmes sistemit të altoparlantëve.)

Të gjithë individët, përfshirë SSA-të, do të ndërmarrin veprimet e duhura të izolimit dhe do të presin mbërritjen e shërbimeve të emergjencës.

Nxënësit trajnohen që:

- Të largohen nga pamja dhe të qëndrojnë në heshtje.

Mësuesit trajnohen që:

- Të kontrollojnë korridorin jashtë klasës për nxënës, të mbyllin derën e klasës dhe të fikin dritat.
- Të [lëvizin jashtë pamjes largohen nga pamja](#) dhe të qëndrojnë në heshtje.
- Të presin derisa ekipet e emergjencës të hapin [derëndyvert e klasës](#) ose derisa të dëgjojnë mesazhin “All Clear” (Gjithçka në rregull): “Izolimi është hequr (The Lockdown has been lifted)”, e ndjekur nga udhëzime specifike.
- Të bëjnë prezencën dhe të raportojnë nxënësit që mungojnë duke kontaktuar zyrën qendrore.

Në një Izolim të Rëndë (Hard Lockdown), mund të ketë raste kur kërkohen veprime shtesë për të minimizuar rrezikun për individët. Të rriturit dhe nxënësit gjithashtu duhet të marrin parasysh të gjitha opsionet e mundshme gjatë një incidenti. Mund t’u duhet të dalin me vrap nga godina për të qëndruar të sigurt dhe të kontaktojnë 911 nëse ndodhen në një zonë që e bën këtë të mundur. Mund t’u duhet të fshihen (të qëndrojnë në izolim) duke u siguruar që janë pas një dore të mbyllur dhe të mbeten në heshtje. Ose, nëse përballen me një kërcënim të menjëhershëm në klasën apo zyrën e tyre, mund t’u duhet të përballen me sulmuesin.

Evakuim

Sistemi i alarmit të zjarrit është sinjali fillestar për stafin dhe nxënësit për të filluar evakuimin. Megjithatë, ndonjëherë sistemi i altoparlantëve (PA system) dhe udhëzime specifike do të shërbejnë si sinjal për të nisur evakuimin. Njoftimet do të fillojnë me “Attention (Vëmendje),” të ndjekura nga udhëzime specifike. (Ky njoftim përsëritet dy herë përmes sistemit të altoparlantëve.)

Nxënësit trajnohen që:

- Të lënë sendet pas dhe të formojnë një rresht të vetëm. Në mot të ftohtë, nxënësit duhet të kujtohen të marrin palltot kur dalin nga klasa. Nxënësit që janë me veshje të edukimit fizik NUK do të kthehen në dhomën e zhveshjes. Nxënësit pa veshje të përshtatshme për jashtë do të vendosen në një vend të ngrohtë sa më shpejt të jetë e mundur.

Mësuesit trajnohen që:

- Marrin dosjen e evakuimit (me listën e prezencës dhe Kartat e Mbledhjes – Assembly Cards).
- Udhëheqin nxënësit në [vendndodhjen vendndodhjet](#) e evakuimit të shënuar në posterët e evakuimit. GJITHMONË TË DËGJOJNË PËR UDHËZIME SHITESË.
- Të bëjnë prezencën dhe të regjistrojnë nxënësit.
- Të raportojnë lëndime, probleme ose nxënës të munguar te stafi i shkollës dhe te shërbimet e emergjencës, duke përdorur Kartat e Mbledhjes.

Strehim Brenda (Shelter-In)

Do të shpallet njoftimi sa vijon: “Attention (Vëmendje): This is a Shelter-In (Ky është një Strehim Brenda). Secure all exit doors (Siguroni të gjitha dyert e daljes).” (Ky njoftim përsëritet dy herë përmes sistemit të altoparlantëve.)

Nxënësit trajnohen që:

- Të qëndrojnë brenda ndërtesës.
- Të vazhdonin aktivitetet normale.
- T’i përgjigjen udhëzimeve specifike të stafit.

Mësuesit trajnohen që:

- Të rrisin vetëdijen ndaj situatës.
- Të vazhdonin aktivitetet normale.

Urdhri “Shelter-In” do të qëndrojë në fuqi deri në momentin kur të dëgjohet mesazhi “All Clear” (Gjithçka në rregull): “The Shelter-In has been lifted (Strehimi Brenda ka përfunduar).” Ky mesazh do të pasohet nga udhëzime specifike.

Anëtarët e Ekipit të Reagimit të Godinës (Building Response Team), përgjegjësit e kateve (floor wardens), dhe stafi i caktuar për Strehim Brenda do të sigurojnë të gjitha daljet dhe do të raportojnë në postet e tyre të caktuara. Ky staf dhe përgjegjësitet e tyre specifike janë përshkruar në secilin Plan të Sigurisë së Godinës (Building Safety Plan).

Qëndrim në Vend (Hold)

Qëndrimi në Vend (Hold) aktivizohet kur ka një situatë brenda ndërtesës së shkollës dhe nevoja e menjëhershme për ta adresuar e kërkon që stafi, nxënësit dhe vizitorët të qëndrojnë në vend dhe të vazhdojnë aktivitetet e zakonshme, deri sa të shpallet njoftimi “All Clear” (Gjithçka në rregull).

Qëndrimi në Vend mund të përdoret për të menaxhuar një incident brenda godinës që nuk e vë komunitetin shkollor në rrezik, ose kurdoherë që udhëzohet nga shërbimet e emergjencës.

Qëndrimi në Vend (Hold) nuk e zëvendëson një Izolim të Lehtë (Soft Lockdown) ose një Izolim të Rëndë (Hard Lockdown).

Do të shpallet njoftimi sa vijon: “Attention (Vëmendje): This is a Hold (Ky është një Qëndrim në Vend). All staff, students, and visitors are to remain where they are until you hear the All Clear (I gjithë stafi, nxënësit dhe vizitorët duhet të qëndrojnë aty ku janë deri sa të dëgjojnë mesazhin Gjithçka është e sigurt).” (Ky njoftim përsëritet dy herë përmes sistemit të altoparlantëve.)

Pas dëgjimit të njoftimit Pritje:

Stafi duhet:

- Të mbyllë derën e vendndodhjes ku ndodhet.
- Të qëndrojnë në vendndodhjen aktuale.
- Të kontaktojnë zyrën qendrore për të raportuar çdo nxënës që ka qenë jashtë klasës në momentin që është dhënë njoftimi.

Nxënësit dhe stafi duhet:

- Të qëndrojnë aty ku janë deri sa të jepet njoftimi “Gjithçka është e sigurt” (“All Clear”).
- Injorojnë çdo zile që zakonisht sinjalizon mbarimin e orës.

- Të kujtojnë se nuk përdoret leja për dalje nga klasa, dhe të gjithë duhet të qëndrojnë në vend deri sa Qëndrimi në Vend të përfundojë.

b) Reagimi ndaj Kërcënimeve, Akteve Kriminale, dhe Vlerësimit të Kërcënimit

Zyrtarët e shkollës duhet të jenë të përgatitur për të reaguar ndaj kërcënimeve ose akteve të sjelljes kriminale nga nxënës, personel i shkollës ose vizitorë, që variojnë nga sulme fizike deri te kërcënimet me bombë. Procedurat për njoftimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit për incidente që lidhen me shkollën, krime të kryera nga nxënës ose punonjës të shkollës, ose emergjenca mjekësore, përmbahen në Rregulloren e Kancelarit A-412 (Chancellor's Regulation A-412) (shih Dokumentet Kryesore më poshtë) dhe rregullore të tjera, përfshirë Protokollat e Reagimit ndaj Kërcënimeve (Threat Response Protocols). Siç përshkruhet më sipër, [Protokollet e Përgjithshme të Reagimit \(General Response Protocols—GRP\)](#) do të përdoren për të reaguar ndaj të gjitha kërcënimeve dhe akteve të dhunës, së bashku me një reagim të menjëhershëm nga stafi i distriktit dhe shërbimet e emergjencës të thirrura përmes 911. Pas mbërritjes, të gjitha përpjekjet e distriktit dhe të reagimit emergjent do të koordinohen me zyrtarët e shkollës dhe SSA-të për të ofruar mbështetje të përshtatur sipas incidentit.

Zyrtarët e shkollës duhet gjithashtu të jenë të përgatitur për të reaguar ndaj kërcënimeve nga nxënësit kundër vetes së tyre. Procedurat për ngritjen e një Ekipi të Krizës së Shkollës dhe për trajtimin e tentativave për vetëvrasje, sjelljeve vetëvrasëse dhe mendimeve vetëvrasëse përmbahen në Rregulloren e Kancelarit A-755 dhe në rregullore të tjera (shih Dokumentet Kryesore më poshtë).

Kur një nxënës angazhohet në sjellje që paraqet rrezik të madh për dëmtim të vetes ose të tjerëve, zyrtarët e shkollës duhet të bëjnë çdo përpjekje për të ulur në mënyrë të sigurt intensitetin e sjelljes, duke përdorur strategji dhe ndërhyrje për trajtimin e krizave të sjelljes dhe duke shfrytëzuar burimet brenda shkollës dhe në komunitet të përcaktuara në Planin e Shkollës për Uljen e Krizës (Crisis De-escalation Plan). Përveç kësaj, prindit duhet t'i jepet mundësia të flasë me nxënësin nëse kushtet e sigurisë e lejojnë. Shih Rregulloren e Kancelarit A-411 (Chancellor's Regulation A-411) për më shumë informacion mbi reagimin ndaj një nxënësi në krizë të sjelljes.

c) Personeli i Sigurisë në Shkollë:

Në shtator të vitit 1998, DOE, Kancelari, dhe Qyteti i Nju Jorkut nënshkruan një marrëveshje për të zbatuar një program të përbashkët mes DOE dhe Departamentit të Policisë së Nju Jorkut (New York Police Department – NYPD), sipas të cilit funksionet e sigurisë së shkollës, duke përfshirë përzgjedhjen, vendosjen, trajnimin, vlerësimin dhe menaxhimin e personelit të sigurisë së shkollës, do të ishin përgjegjësi e NYPD. Kjo marrëveshje u vazhdua më pas dhe pastaj u modifikua më 19 qershor 2019, [në një memorandum mirëkuptimi \(MM\) të rishikuar](#).

Memorandumi i Rishikuar i Mirëkuptimit (MOU) vazhdon të përmbajë kuadrin për ofrimin e sigurisë në shkollat e DOE dhe adreson rolin e administratorëve të shkollave, SSA (School Safety Agents) dhe NYPD në ruajtjen e një mjedisi të sigurt shkollor; thekson rolin parësor të shkollës në trajtimin e sjelljes së papërshtatshme të nxënësve; përcakton rrethanat kur stafi i shkollës duhet të kontaktojë SSA për të trajtuar sjelljen e papërshtatshme të nxënësve; parashikon trajnime për SSA dhe oficerët e NYPD, duke përfshirë në uljen e tensioneve; përfshin procedura për kur dhe si NYPD mund të marrë në pyetje nxënës në godinën e shkollës; përcakton pritshmëritë se kur mund të bëhet një arrestim ose të lëshohet një gjobë me kufizimin minimal të nevojshëm; dhe parashikon përdorimin e [alternativave ose](#) masave shmangëse [ose alternativave](#) në vend të arrestimit ose lëshimit të një gjobe.

Memorandumi i Rishikuar i Mirëkuptimit (MOU) është përfshirë në Dokumentet Kryesore më poshtë.

d) Trajnime dhe Ushtrime

Të gjithë drejtorët janë të detyruar të përfundojnë trajnimin e detyrueshëm për Gatishmëri ndaj Emergjencave (Emergency Readiness), i cili është i vlefshëm për dy vjet. Trajnimi ofrohet gjatë muajve korrik dhe gusht, si dhe gjatë vitit shkollor për drejtorët e rinj që fillojnë punën pas 1 shtatorit.

I gjithë stafi i DOE duhet të marrë trajnim vjetor mbi procedurat e emergjencës që përdoren në shkolla dhe ndërtesat administrative të agjencisë, si dhe mbi zbulimin e hershëm të sjelljes potencialisht të dhunshme. Një Paketë Trajnimi për Ditën e Hapur Vjetore (Annual Opening Day Training Deck) u ofrohet të gjitha shkollave për ta lehtësuar këtë trajnim përpara datës 15 shtator dhe sipas nevojës gjatë vitit shkollor për punonjësit e rinj. Stafi i DOE që nuk është i caktuar në ndërtesat e shkollës duhet të përfundojë një modul trajnimi online përpara datës 15 shtator ose brenda 30 ditëve nga punësimi.

Të gjithë nxënësit duhet të marrin trajnim mbi protokollet e reagimit emergjent dhe burimet e disponueshme të shkollës në fillim të çdo viti shkollor. Mësime për rishikimin e GRP duhet të zhvillohen me të gjithë nxënësit në fillim të çdo viti shkollor. Materialet e trajnimit vihen në dispozicion të shkollave për këtë qëllim, duke përfshirë prezantime PowerPoint, video dhe plane mësimore.

Informacioni që lidhet me procedurat e emergjencës në shkollë, përfshirë GRP, duhet të ndahet edhe me familjet në fillim të çdo viti shkollor. Një letër hyrëse dhe një përmbledhje e procedurave të emergjencës u ofrohen shkollave për t'u shpërndarë familjeve.

Të gjitha shkollat janë të detyruara të zhvillojnë ushtrime emergjence të ndjeshme ndaj traumës që testojnë përbërësit e planit të tyre të reagimit emergjent. Këto ushtrime të detyrueshme duhet të përfshijnë të gjithë nxënësit dhe stafin që kanë nevojë për ndihmë të veçantë gjatë një evakuimi emergjent, të cilët duhet të dërgohen në dhoma pritjeje të miratuara nga FDNY (Departamenti i Zjarrfikësve të Nju Jorkut – Fire Department of New York), zona shpëtimi, zona ndihme për shpëtim, ose Dhoma të Tërheqjes (Retreat Rooms) të identifikuar nga Komiteti i Sigurisë së Shkollës kur nuk janë përcaktuar dhoma nga FDNY.

Drejtorët duhet të zhvillojnë të paktën 12 ushtrime emergjence gjatë ushtrimit e mëposhtme për emergjencën çdo vit vitit shkollor:

- Të paktën tetë ushtrim evakuimi, gjashtë prej të cilave duhet të zhvillohen kryhen deri më 31 dhjetor. Tetë ushtrimet duhet të përfshijnë evakuim dhe ushtrime izolimi (lockdown).
- Të paktën katër nga 12 ushtrimet duhet të jenë ushtrime izolimi, një karantine, dy prej të cilave duhet të zhvillohet kryhen deri më 31 dhjetor. Një ushtrim karantine duhet të kryhet deri më 31 tetor, dhe një tjetër duhet të zhvillohet kryhet midis 1 shkurtit – dhe 14 marsit. Dy ushtrimet e fundit mund të zhvillohen sipas zgjedhjes së shkollës.

Ushtrimet duhet të zhvillohen në rrethana të ndryshme, në ditë dhe orare të ndryshme, përfshirë gjatë pushimeve të dregës dhe në kohë të paparalajmëruara, për të simuluar kushte reale emergjence.

Drejtorët duhet të sigurojnë që ushtrimet e zhvilluara gjatë ditës së shkollës, me nxënës të pranishëm, të realizohen në mënyrë të ndjeshme ndaj traumës, të përshtatshme për zhvillimin dhe moshën e nxënësve, dhe të mos përfshijnë skena të improvizuara, aktorë, simulime ose taktika të tjera të menduara për të imituar një sulm me armë në shkollë apo ndonjë akt tjetër dhune ose emergjence. Në kohën kur zhvillohen stërvitjet, nxënësit dhe stafi duhet të informohen se aktivitetet që po kryhen zhvillohen janë ushtrimenjë ushtrim. Prindërit ose personat me rol prindëror në marrëdhënie prindërore duhet të njoftohen të paktën brenda një javë përparajave para ushtrimit.

Shkollat mund të marrin pjesë vetëm në ushtrime të plota (full-scale exercises) të zhvilluara dhe të planifikuara nga DOE dhe nga autoritetet vendore të emergjencave dhe përgatitjes. Këto ushtrime nuk mund të planifikohen gjatë një dite të zakonshme shkollore ose kur po zhvillohen aktivitete shkollore në ambientet e

shkollës. Këto ushtrime nuk mund të përfshijnë nxënës pa pëlqimin me shkrim të prindërve ose personave me rol prindëror.

Në bashkëpunim me shërbimet e emergjencës të NYC (NYPD, FDNY dhe NYCEM – New York City Emergency Management), DOE vëzhgon ushtrime të ndryshme që zhvillohen në ndërtesa të ndryshme shkollë në çdo bashki, për të vlerësuar reagimin e tyre ndaj emergjencave që kërkojnë evakuim, strehim brenda ose izolim. Ekipi zhvillon një analizë përmbledhëse me drejtuesit e shkollës, si dhe një analizë me agjencitë e tjera për të vlerësuar efektivitetin dhe për të identifikuar çdo fushë ku mund të nevojiten masa korigjuese.

e) Njoftimi për Prindërit:

Kërcënimi për të kryer ose kryerja e një akti dhune në një shkollë prek të gjithë komunitetin shkollor. Në rast kërcënimesh ose aktesh dhune, zyrtarët e shkollës duhet të jenë të përgatitur të kontaktojnë agjencitë përkatëse të zbatimit të ligjit (siç përcaktohet më sipër) dhe të njoftojnë, pa vonesë, komunitetin e shkollës, veçanërisht prindërit e fëmijëve të regjistruar në shkollë. Rregulloret dhe procedurat e DOE për njoftimin e prindërve (në gjuhën e tyre të preferuar) përshkruhen në Rregulloret e Kancelarit dhe rregulloret e tjera (shih Dokumentet Kryesore më poshtë). Në përputhje me Rregulloren e Kancelarit A-415, prindërit, stafi dhe zyrtarët e zgjedhur mund të regjistrohen vullnetarisht për të marrë njoftime emergjence përmes mesazheve elektronike, thirrjeve telefonike dhe/ose email-it përmes NotifyNYC. Përveç kësaj, drejtuesit e shkollës mund të përdorin sisteme njoftimi specifike të shkollës për të alarmuar prindërit dhe komunitetin shkollor për emergjencë specifike që ndodhin në shkollë. DOE ka zhvilluar një mjet të sigurt mesazhesh që u lejon shkollave të krijojnë dhe të dërgojnë komunikime për familjet, nxënësit dhe stafin. Shkollat mund të dërgojnë njoftime në kohë reale për familjet nga një pajisje celulare ose kompjuter, në rast emergjence, si Izolim (Lockdown), Evakuim (Evacuation), Hold (Pritje) ose Strehim Brenda (Shelter-In). Kur dërgojnë mesazhe që nuk përfshihen në opsionin automatik të modelit të mesazheve, shkollat duhet të konsultohen me superintendentin, këshilltarin [e lartë](#) në terren dhe [Zyrënzyrën](#) e [Shtypit;shtypit](#) për hartimin e këtyre njoftimeve.

2 – Plani i sigurisë së shkollës në nivel ndërtesë:

Në përputhje me Rregulloren e Kancelarit A-414, (shih Dokumentet Kryesore më poshtë), çdo shkollë duhet të krijojë një Komitet të Sigurisë së Shkollës (School Safety Committee) për të zhvilluar një plan sigurie në nivel ndërtesë. Çdo komitet duhet të përfshijë personat e mëposhtëm: UFT Chapter Leader; Inxhinierin në Detyrë ose të deleguarin e tij; Agjentin e Brendshëm të Sigurisë së Shkollës Nivel III ose të deleguarin; zyrtarë të zbatimit të ligjit lokal; Presidentin e Shoqatës së Prindërve ose të deleguarin; dietologun ose përfaqësuesin e shërbimeve ushqimore të vendit; Koordinatorin e Transportit të Bazuar në Shkollë; një anëtar të stafit të shkollës të përfaqësuar nga DC-37; anëtarë të komunitetit; zyrtarë lokalë të zjarrfikësve, ambulancës ose agjencive të tjera të emergjencës; përfaqësues të trupës studentore (kur është e përshtatshme); dhe çdo person tjetër i konsideruar i përshtatshëm nga drejtori. Siç përcaktohet në çdo plan sigurie të shkollës, çdo shkollë është e detyruar të krijojë një Zinxhir Komandues (Chain of Command) dhe disa ekipe, përfshirë një Ekip Reagimi për Ndërtesën (Building Response Team) dhe një Ekip Krize (Crisis Team), si dhe të caktojë personel administrativ që koordinojnë reagimin e shkollës në situata emergjente.

Plani gjithashtu përshkruan, ndër të tjera, procedurat e hyrjes në ndërtesë dhe kontrollit të vizitorëve; detyrat dhe oraret e sigurisë; procedurat për ndërhyrjen ndaj personave të paautorizuar; sistemet e komunikimit emergjent, duke përfshirë emrat dhe numrat e telefonit të personelit përkatës të zbatimit të ligjit; protokollin për nxënësit e humbur; vlerësimin e rrezikut si pjesë e Programit për Parandalimin e Dhunës në Vendin e Punës (Workplace Violence Prevention Program); procedurat për reagimin ndaj alarmeve të dymëve; dhe procedurat e evakuimit për të gjithë stafin dhe nxënësit, përfshirë ata që kanë nevojë për ndihmë të veçantë gjatë një evakuimi emergjent, dhe planet e kateve të ndërtesës. Çdo plan përshkruan rolet dhe trajnimin e Ekipit të Reagimit për Ndërtesën për të adresuar të gjitha protokollat e reagimit emergjent për nxënësit dhe stafin. Çdo plan në nivel ndërtesë përcakton protokollat për reagimin ndaj situatave emergjente, si derdhjet

kimike, persona të paautorizuar, kërcënimet me bombë, marrjen peng ose të shtënat, duke përfshirë nëse duhet të bëhet Evakuim, Strehim Brenda (Shelter-In), Hold (Pritje) ose Izolim (Lockdown). Planet në nivel ndërtese duhet të jenë në përputhje me një model plani sigurie të zhvilluar nga ~~Zyra e Sigurisë dhe Partneritetet e Parandalimit (Office of Safety and Prevention Partnerships—OSSP) OSPP~~ dhe duhet të përditësohen çdo vit. Informacioni mbi sigurinë në nivel ndërtese që mund të ndahet me stafin dhe familjet është i disponueshëm, me kërkesë, nga secili drejtor në versionin për staf ose prindër të planit të sigurisë së shkollës. Një model i udhëzuesit për prindërit është përfshirë në seksionin e Dokumenteve Kryesore më poshtë. Në përputhje me ligjin shtetëror, planet e reagimit emergjent në nivel ndërtese duhet të jenë konfidenciale dhe nuk duhet të bëhen publike.

[Planet e sigurisë shkollore në nivel ndërtese përfshijnë procedura për aktivitetet dhe ngjarjet pas shkolle, në përputhje me kërkesat e ligjit shtetëror në fuqi.](#)

3 – Ekipi Qendror i Reagimit i DOE (DOE Central Response Team – CRT)

CRT u krijua nga drejtuesit e DOE për të zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse të reagimit emergjent që do të mundësonte koordinimin e zyrave të ndryshme të DOE kur ndodh një incident në pronën e DOE që kërkon reagimin e disa divizioneve të DOE dhe/ose agjencive të jashtme/kompanive të shërbimeve. CRT do të përgjigjet gjithashtu ndaj ngjarjeve të tjera si kushte të rënda moti dhe përdorimi i shkollave për të adresuar një emergjencë të shëndetit publik. CRT do të lehtësojë mbledhjen e të dhënave dhe informacionit duke mundësuar marrjen e vendimeve në kohë nga Drejtuesit e Lartë dhe njoftimin e shpejtë të stafit përkatës të DOE. CRT aktivizohet në zyrat qendrore të DOE për të vlerësuar ndikimin e një situatë që prek shëndetin/sigurinë e nxënësve dhe funksionimin e pajisjeve/ndërtesave shkollore. Duke bërë këtë, CRT do të komunikojë rreziqet dhe veprimet që duhet të ndërmerren nga komuniteti shkollor dhe do të zhvillojë një analizë përmbledhëse pas çdo aktivizimi për të përmirësuar vazhdimisht gatishmërinë dhe veprimet parandaluese për incidentet e ardhshme.

CRT mban marrëdhënie të rëndësishme me agjenci të tjera të NYC ku përfshihen NYPD, FDNY, [Autoriteti i Transportit Metropolitan \(MTA\)](#), NYCEM dhe ekipe të tjera menaxhimi emergjent në agjenci të ndryshme si DOHMH dhe DSS; herë pas here CRT do të angazhohet edhe me American Red Cross (Kryqin e Kuq Amerikan). Brenda DOE, CRT siguron që përpjekjet e të gjitha ekipeve kritike të DOE në terren, përfshirë por pa u kufizuar në: Godinat e Shkollës dhe Zëvendës Drejtorët e saj të Infrastrukturës (Deputy Directors of Facilities – DDF); Partneritetet për Siguri dhe Parandalim (Safety and Prevention Partnerships) dhe Drejtorët e Sigurisë së Bashkive (Borough Safety Directors – BSD), të jenë të koordinuara. DDF-të dhe BSD-të janë mbështetja direkte në rast emergjence për Drejtorët dhe drejtuesit e secilit Ekip Reagimi për Ndërtesën (Building Response Team – BRT) në çdo shkollë.

4 – Plani i ~~Vazhdimësisë~~ [vazhdimësisë](#) së operacioneve (COOP)

Plani i DOE për Vazhdimësinë e Operacioneve (COOP) është një qasje gjithëpërfshirëse për të mundësuar vazhdimin e shërbimeve thelbësore gjatë ndërprerjeve. Plani i nënshtrohet përditësimeve tremujore dhe një rishikimi vjetor nga drejtuesit ekzekutivë të DOE, me Menaxhimi i Emergjencave i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Emergency Management – NYCEM) që ofron mbikëqyrje sipas Urdhrit Ekzekutiv 107. ~~DOE COOP~~ [Plani](#) merr në konsideratë përbërësit dhe proceset kritike për çdo shërbim thelbësor, duke përfshirë rendin e pasueshmërisë, delegimet e autoritetit, objektet alternative, komunikimet për vazhdimësinë, menaxhimin e dokumenteve thelbësore, kapitalin njerëzor, protokollat e devolucionit dhe procedurat e rikthimit. Efektiviteti i planit përmirësohet përmes testeve dhe trajnimeve vjetore ~~—~~.

Plani ~~+DOE COOP~~ trajton një numër fushash të lidhura me emergjencat, duke përfshirë, por pa u kufizuar në sa vijon:

- Sigurimin e Sigurisë dhe Mbrotjtjes së Godinave (Life Safety) – Mbajtjen e ndërtesave shkollore të

sigurta, të mbrojtura dhe funksionale (p.sh., sistemet kundër zjarrit, bravat e dyerve, daljet e emergjencës).

- Koordinimi i Komunikimeve Emergjente (Life Safety) – Menaxhimi i alarmimeve, njoftimeve dhe komunikimeve gjatë krizave (p.sh., emergjenca, mbyllje shkollash).
- Dhënia e Mësimi Edukativ (Shërbim Publik Kritik) – Sigurimi i mësimdhënies dhe të mësuarit, qoftë me prani fizike ose në distancë, për të garantuar që arsimi i nxënësve të vazhdojë.
- Ofrimi i Shërbimeve Mbështetëse për Nxënësit (Shërbim Publik Kritik) – Ofrimi i këshillimit, arsimit special, shërbimeve shëndetësore dhe ndihmave të tjera për nxënësit.
- Mbajtja e Ushqyerjes dhe Mirëqenies së Nxënësve (Shërbim Publik Kritik) – Sigurimi i qasjes në vakte (mëngjes/drekë) dhe nevoja bazike për nxënësit, veçanërisht ata në nevojë.
- Funksionimi i Infrastrukturës Teknologjike – Mbajtja në punë e sistemeve kritike të IT-së (p.sh., interneti, pajisjet, platformat e të mësuarit online).
- Përpunimi i Pagave dhe Funksioneve Kritike të Burimeve Njerëzore – Sigurimi që stafi dhe mësuesit të paguhen me kohë dhe që operacionet thelbësore të burimeve njerëzore të vazhdojnë.
- Menaxhimi i Funksioneve Kritike Administrative – Trajtimi i dokumentacionit esencial, buxheteve, përputhshmërisë dhe operacioneve për të mbajtur shkollat në funksion.

5 - Transporti

Në përputhje me Rregulloren e Kancelarit A-801 (shih Dokumentet Kryesore më poshtë), DOE ofron transport për të gjithë nxënësit e kualifikuar të Qytetit të Nju Jorkut në shkollat publike, charter dhe jo-publike. Në partneritet me Metropolitan Transit Authority (MTA) dhe kompanitë e autobusëve, misioni ynë është të sigurojmë transport të sigurt dhe të besueshëm drejt dhe nga shkolla. Ky punim koordinohet dhe menaxhohet nga Zyra e Transportit të Nxënësve ([Office of Pupil Transportation — OPT](#)).

OPT përdor një qasje gjithëpërfshirëse me katër pjesë për të prioritetizuar sigurinë e nxënësve, duke theksuar trajnimin e punonjësve, menaxhimin e fuqisë punëtore, mirëmbajtjen e automjeteve, dhe menaxhimin e incidenteve.

Trajnimi i Punonjësve: Trajtimi i detyruar nga shteti zhvillohet për të gjithë shoferët e autobusëve dhe asistentët nga kompanitë e kontraktuara të autobusëve. Përveç kësaj, DOE ofron trajnim vjetor që përcillet tek stafi i autobusëve. Temat e mbuluara përfshijnë:

- Iniciativat për drejtim më të sigurt Vision Zero.
- Ndërgjegjësim më i lartë mbi teknikat e drejtimit të synuara për të përmirësuar sigurinë.
- Si të përdoret një autobus në mënyrë të sigurt, përfshirë funksionimin e ashensorëve dhe sigurimin e karrigeve me rrota.
- Si të hipen/zbriten dhe të kujdesen fëmijët në një autobus në mënyrë të sigurt.
- Kujdesi për fëmijët me nevoja të veçanta.

Menaxhimi i Fuqisë Punëtore: Një ekip i dedikuar në OPT është përgjegjës për të siguruar përputhshmërinë dhe sjelljen e punonjësve, si:

- Sigurimi që të gjitha certifikatat, trajnimet dhe licencat e punonjësve të jenë të përditësuara.
- Sigurimi që sjellja e pahijshme e punonjësve të trajtohet në mënyrë të përshtatshme dhe të shpejtë, duke përfshirë pezullimet dhe riorientimet e punonjësve.
- Inspektimet e punonjësve në oborret e automjeteve për të siguruar që punonjësit e certifikuar janë duke operuar dhe kujdesur për automjetet.
- Mirëmbajtja e Automjeteve: Një ekip i dedikuar në OPT siguron sigurinë dhe mirëmbajtjen e automjeteve, duke përfshirë inspektimet e automjeteve në oborret e autobusëve për të siguruar që automjetet e certifikuar nga OPT janë në përdorim.

- Kërkesat për moshën e automjeteve për të siguruar që ato të jenë të përditësuara.
- Sistemet GEOTAB (GPS) për të gjurmuar sjelljen dhe sigurinë e shoferëve.

Menaxhimi i Incidenteve përfshin:

- Rishikimin ditor, në kohë reale, të incidenteve që ndodhin në autobusë për të siguruar sigurinë e nxënësve.
- Ndjekjen e menjëhershme dhe përcaktimin e hapave të mëtejshëm me shkollat, stafin e brendshëm të OPT, stafin e DOE nga divizione të tjera dhe kompanitë e autobusëve.
- Rishikimin e të dhënave për të identifikuar shkolla dhe linja autobusësh që kanë nevojë për trajnim dhe mbështetje të synuar.

6 – Kodi i Sjelljes

Kodi i Sjelljes përfshin rregulloret dhe procedurat e DOE që rregullojnë sjelljen e nxënësve, duke përfshirë Pritshmëritë e Sjelljes në Të Gjithë Qytetin për të Mbështetur të Mësuarin e Nxënësve (Citywide Behavioral Expectations to Support Student Learning – Discipline Code), i cili përcakton standardet e pritshme të sjelljes dhe një gamë ndërhyrjesh, mbështetjesh dhe reagimesh disiplinore për përfshirjen në sjellje të papërshtatshme; dispozitat për trajtimin dhe reagimin ndaj diskriminimit, ngacmimit, frikësimit dhe/ose bullizmit; rregulloret dhe procedurat për realizimin e largimeve dhe pezullimeve; rregulloret dhe procedurat për njoftimin e prindërve (në gjuhën e tyre të preferuar); kërkesat për raportim; kërkesat për njoftimin e organeve të zbatimit të ligjit; kërkesat për trajnimin e stafit; dhe Kartën e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësve (Bill of Student Rights and Responsibilities), e cila fokusohet tek sjellja pozitive dhe ndërtimi i një klime shkollore të sigurt dhe mbështetëse.

~~Një fëmijë nën moshën 18 vjeç që nuk ndjek shkollën, sillet në një mënyrë të rrezikshme ose jashtë kontrollit, ose shpesh nuk bindet ndaj prindërve, kujdestarëve apo autoriteteve të tjera, duhet t'i referohet Programit të Vlerësimit të Familjes (Family Assessment Program). Prindërit janë të detyruar të marrin shërbime shmangëse përmes Programit të Vlerësimit të Familjes (Family Assessment Program – FAP) të Administratës për Shërbimet e Fëmijëve (Administration for Children's Services – ACS), përpara se të paraqesin një Kërkesë PINS (PINS Petition). Faqja e internetit e FAP (Family Assessment Program) përfshin informacion rreth PINS. (<https://www1.nyc.gov/site/acs/justice/family-assessment-program.page>). Prindërit mund të kërkojnë me dëshirë shërbime parandaluese duke telefonuar Linjën e Ndhmës për Parandalimin (Prevention Helpline) në (212) 676-7667. Shkolla gjithashtu mund të identifikojë shërbime dhe të lidhë familjen me ofruesin përkatës. (ACS – Preventive Services (Shërbime Parandaluese) (nyc.gov) Kur dyshohet për mungesa të pajustificuara (truancy) dhe/ose sjellje të papërshtatshme në shkollë, FAP ose ofruesi i shërbimeve parandaluese do të rishikojë hapat e ndërmarrë nga shkolla për të përmirësuar ndjekjen/sjelljen e nxënësit dhe do të përpiqet të përfshijë shkollën në përpjekje të mëtejshme parandaluese. FAP do të kontaktojë shkollën për të zgjidhur problemet e mungesës ose sjelljes së nxënësve në mënyrë që të shmanget nevoja për të paraqitur një kërkesë (petition), ose, të paktën, për të adresuar pretendimet e lidhura me arsimin. Anëtarët e stafit të DOE mund të kërkojnë gjithashtu të ofrojnë dokumentacion mbi ndërhyrjet dhe arsyet pse çështjet arsimore nuk mund të zgjidhen pa paraqitur një kërkesë PINS (PINS petition). Gjykatësi i Gjykatës së Familjes (Family Court Judge) mund të kërkojë që stafi i shkollës të paraqitet në gjykatë nëse paraqitet një kërkesë PINS, dhe gjykata beson se ndihma e stafit të shkollës mund të ndihmojë në zgjidhjen e çështjeve të lidhura me arsimin.~~

a) Kodi i Disiplinës:

Kodi i Disiplinës përcakton një kuadër për reagimin ndaj sjelljes së papërshtatshme të nxënësve. Ai përcakton që çdo përpjekje e arsyeshme duhet të bëhet për të korrigjuar sjelljen e nxënësit përmes këshillimit dhe ndërhyrjeve të tjera në shkollë, si praktikat riparuese. Gjithashtu përcakton që reagimet disiplinore të përshtatshme duhet të theksojnë parandalimin dhe ndërhyrjen efektive, të forcojnë qëndrueshmërinë, të parandalojnë ndërprerjen e procesit arsimor të nxënësve dhe të promovojnë një kulturë pozitive në shkollë. Ai

përfshin një gamë ndërhyrjesh progresive të përshtatshme për moshën, mbështetjesh dhe reagimesh disiplinore që mund të përdoren për t'iu përgjigjur sjelljes së papërshtatshme të nxënësve.

b) Strategjitë e Ndërhyrjes:

Çdo shkollë pritet të promovojë një kulturë dhe klimë pozitive shkollore që u ofron nxënësve një mjedis mbështetës ku ata të rriten si në aspektin shoqëror ashtu edhe akademik. Shkollat pritet të marrin një rol proaktiv në kultivimin e sjelljes pro-sociale të nxënësve duke u ofruar atyre një gamë mbështetjesh pozitive të sjelljes, si dhe mundësi domethënëse për të mësuar mbi zhvillimin social-emocional.

Anëtarët e stafit të shkollës janë përgjegjës për trajtimin e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve që prishin procesin e të mësuarit. Administratorët, mësuesit, këshilltarët dhe stafi tjetër i shkollës pritet të angazhojnë të gjithë nxënësit në strategji ndërhyrjeje dhe parandalimi që trajtojnë çështjet e sjelljes së nxënësit dhe të diskutojnë këto strategji me nxënësin dhe prindërit.

[Kur një fëmijë nuk ndjek shkollën ose është i përfshirë në sjellje që paraqesin shqetësime për sigurinë ose është e vështirë për t'u menaxhuar nga prindërit ose kujdestarët, familjet mund të referohen në Programin e Vlerësimit Familjar \(FAP\) të Administratës për Shërbimet e Fëmijëve \(ACS\) ose në Linjën e Mbështetjes së ACS në 212 676-7667 nëse janë të interesuar për mbështetje shtesë.](#)

Strategjitë e ndërhyrjes janë të përshkruara në Kodin e Disiplinës (Discipline Code) dhe mund të përfshijnë: konferenca udhëzuese, kontakt me prindërit, zgjidhje konfliktesh, raporte afatshkurtra të progresit të sjelljes, kontrata individuale të sjelljes, ndërhyrje këshillimi, referim tek ekipi i personelit të nxënësve, praktika riparuese (restorative practices), zgjidhje bashkëpunuese të problemeve, këshillim individual ose në grup, plane individuale mbështetëse, referim për shërbime këshillimi, mentorim, të mësuarit social-emocional (social-emotional learning), dhe lidhje me organizata të bazuara në komunitet. Shkollat pritet të dokumentojnë ndërhyrjet e zbatuara me nxënësit dhe të vlerësojnë rregullisht ndikimin e këtyre qasjeve.

~~Përmes përdorimit të strategjive të ndërhyrjes dhe parandalimit që angazhojnë nxënësit dhe u japin atyre një ndjenjë qëllimi, anëtarët~~ Anëtarët e stafit të shkollës lehtësojnë rritjen akademike dhe social-emocionale të nxënësve dhe i ndihmojnë ata të ndjekin rregullat dhe politikat e shkollës [përmes strategjive të ndërhyrjes dhe parandalimit që i angazhojnë nxënësit dhe u japin atyre një ndjenjë qëllimi.](#)

Në klasë, mësuesit përdorin një shumëllojshmëri teknikash dhe qasjesh akademike dhe të sjelljes për të arritur një mjedis optimal për të mësuarit. Ekipet ndërdisiplinore që përfshijnë stafin mbështetës, si këshilltarët arsimorë, janë pjesë e çdo shkolle. Këto ekipe mblidhen rregullisht për të hartuar dhe zbatuar strategji për të trajtuar çështje specifike me të cilat përballen nxënësit “në rrezik”.

Kur është e përshtatshme, reagimet disiplinore progresive dhe të përshtatshme për moshën duhet të zbatohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Kancelarit A-443 dhe Kodin e Disiplinës. (shih Dokumentet Kryesore më poshtë).

c) Diskriminimi, Ngacmimi, Frikësimi dhe Bullizmi:

Është rregullore e DOE të ruajë një mjedis të sigurt dhe mbështetës për të mësuarit dhe edukimin, që është i lirë nga ngacmimi, frikësimi dhe/ose bullizmi i kryer nga nxënës ndaj nxënësve të tjerë dhe diskriminimi nga nxënësit ndaj nxënësve të tjerë për shkak të racës, ngjyrës, besimit, etnisë, origjinës kombëtare, statusit të shtetësisë/imigrimit, fesë, gjinisë, identitetit gjinor, shprehjes gjinore, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, ose peshës. Rregullorja e DOE përcaktohet në Rregulloren e Kancelarit A-832 dhe në Kodin e Disiplinës. (shih Dokumentet Kryesore më poshtë) Këto dokumente përcaktojnë procedurat për parandalimin, raportimin, hetimin dhe reagimin ndaj një sjelljeje të tillë.

Të gjithë nxënësit dhe stafi duhet të marrin trajnim mbi kërkesat e Rregullores së Kancelarit A- 832. OSYD ofron burime të shumta, përfshirë mësim dhe kurrikula, si dhe një udhëzues të detajuar për zbatimin, për t'i

ndihmuar shkollat të ofrojnë këtë informacion për nxënësit. Përveç kësaj, ajo zhvillon dhe vë në dispozicion një paketë trajnimi dhe burime shtesë, të cilat drejtuesit e shkollave mund t'i përdorin për të përmbushur kërkesën për të trajnuar të gjithë punonjësit, përfshirë stafin jo-mësuesor.

d) Angazhimi dhe Njoftimi i Prindërve:

Nxënësit, prindërit dhe personeli i shkollës kanë të gjithë një rol në mbajtjen e shkollave të sigurta dhe duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të arritur këtë qëllim. Stafi i shkollës duhet t'i mbajë prindërit të informuar për sjelljen e fëmijës së tyre dhe t'i angazhojë ata si partnerë në trajtimin e çështjeve problematike. Përveç nëse ka një urdhër gjykatë që kufizon qasjen, prindërit e nxënësve në kujdesin e përkohshëm kanë të drejtë të informohen për sjelljen e fëmijës së tyre dhe masat disiplinore, përveç prindit kujdestar dhe agjencisë.

Për të siguruar që prindërit të [jenë mund të bëhen](#) partnerë aktivë dhe të përfshirë në promovimin e një mjedisi shkollor të sigurt dhe mbështetës, ata duhet të njihen me kodin e disiplinës.

Shkollat inkurajohen të ofrojnë punëtori për prindërit mbi kuptimin e Kodit të Disiplinës dhe mënyrën më të mirë për të bashkëpunuar me shkollën në mbështetje të zhvillimit social-emocional të fëmijës së tyre. OSYD zhvillon dhe vë në dispozicion paketa trajnimi për punëtori (workshop training decks) të krijuara për t'i ndihmuar administratorët dhe koordinatorët e prindërve në prezantimin e informacionit mbi Kodin e Disiplinës për prindërit.

Arsimtarët janë përgjegjës për të informuar prindërit mbi sjelljen e fëmijës së tyre dhe për të nxitur aftësitë që nxënësit kanë nevojë për të pasur sukses në shkollë dhe në shoqëri. Prindërit inkurajohen të diskutojnë me mësuesin e fëmijës së tyre dhe me stafin tjetër të shkollës rreth çështjeve që mund të ndikojnë në sjelljen e nxënësit dhe strategjive që mund të jenë efektive për të punuar me të.

Prindërit që dëshirojnë të diskutojnë rreth mbështetjes dhe ndërhyrjeve në përgjigje të sjelljes së nxënësit duhet të kontaktojnë shkollën e fëmijës së tyre, përfshirë koordinatorin e prindërve, ose, nëse është e nevojshme, Zyrën e Fuqizimit të Familjes dhe Komunitetit (Office of Family and Community Empowerment).

~~Në rast se~~[Nëse](#) një nxënës përfshihet në një sjellje që shkel Kodin e Disiplinës, drejtori ose përfaqësuesi i caktuar i tij duhet ta raportojë sjelljen te prindërit e nxënësit.

e) Trajnimi:

Sigurimi që çdo fëmijë të mësojë në shkolla të sigurta, mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse është prioriteti kryesor i DOE. Për ta arritur këtë, DOE përdor qasje riparuese (restorative approaches) që adresojnë shkaqet reale të konflikteve, si dhe forcojnë sjelljet pozitive përmes momenteve mësimore. DOE u jep mësuesve burime për të mbështetur aftësitë social-emocionale dhe mirëqenien e nxënësve dhe, si rezultat, ul varësinë nga pezullimet ose disiplinat [e tjera](#) ndëshkuese.

Mënyra se si nxënësit sillen në shkollë është një faktor kryesor në vendosjen dhe ruajtjen e një komuniteti shkollor të sigurt dhe respektues. Për të nxitur sjelljen pozitive të nxënësve, të gjithë anëtarët e komunitetit shkollor – nxënësit, stafi dhe prindërit – duhet të dinë dhe të kuptojnë standardet e sjelljes që pritet të ndjekin të gjithë nxënësit, mbështetjet dhe ndërhyrjet që do të përdoren për të trajtuar sjelljen e papërshtatshme, si dhe reagimet disiplinore nëse standardet e sjelljes nuk respektohen.

Shkollat duhet të caktojnë kohë për të rishikuar me nxënësit Kodin e Disiplinës, Kartën e të Drejtave dhe Përgjegjësisive të Nxënësve ([Student](#)-Bill of Rights and Responsibilities) dhe Rregulloren e Pranueshme të Përdorimit të Internetit dhe Sigurisë (Internet Acceptable Use and Safety Policy) të DOE. Kodi i Sjelljes zbatohet si për sjelljen e nxënësve në prani fizike, ashtu edhe për sjelljen online. Shkollat do t'i edukojnë nxënësit dhe familjet për qytetarinë digjitale dhe parandalimin e bullizmit online, duke përfshirë pritshmëritë për komunikim të respektueshëm online, privatësi dhe siguri. Do të vendosen mekanizma të qartë raportimi

për nxënësit, familjet dhe stafin për të adresuar incidente që përfshijnë komunikime elektronike, përfshirë bullizmin, ngacmimin ose frikësimin në mjedise digjitale.

Mënyra më efektive për të siguruar që nxënësit e kuptojnë dhe e mbështesin Kodin e Disiplinës është përmes mësimin në klasë të përshtatur sipas moshës. Të gjithë nxënësve duhet t'u jepet të paktën një orë mësimore mbi Kodin e Disiplinës. DOE vë në dispozicion plane mësimore të bazuara në standarde, të përshtatshme për moshën, të cilat përfshijnë ushtrime interaktive, projekte të sugjeruara dhe mundësi për përvoja të të mësuarit bashkëpunues midis nxënësve, si dhe një paketë trajnimi për punëtorë (workshope) me nxënësit.

Shkollat duhet të rishikojnë Kodin e Disiplinës me të gjithë anëtarët e stafit dhe të zhvillojnë një punëtorë për të diskutuar qëllimin e kodit. Një model pakete trajnimi për zhvillim profesional (professional development workshop training deck), që përfshin ushtrime interaktive, është i disponueshëm për shkollat për ta përdorur.

7 – Parandalimi i Dhunës në Vendin e Punës

Që nga janari 2024, DOE ka zbatuar një Rregullore për Parandalimin e Dhunës në Vendin e Punës, e cila është krijuar për të përmbushur kërkesat e Ligjit për Punën e Shtetit të Nju Jorkut, Neni 2, Seksioni 27-b.

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, dhuna në vendin e punës përkufizohet si çdo sulm fizik ose sjellje agresive që ndodh aty ku një punonjës kryen një detyrë të lidhur me punën gjatë ushtrimit të punësimit të tij.

Individët që shkelin këtë rregullore mund t'i referohen organeve të rendit, të largohen nga prona e DOE, dhe/ose t'i nënshtrohen veprimeve disiplinore dhe/ose personelit, në përputhje me rregulloret, politikat, dhe marrëveshjet kolektive të DOE. DOE ka krijuar gjithashtu një [Program për Parandalimin e Dhunës në Vendin e Punës](https://infohub.nyced.org/nyc-doe-roles/human-resources/employee-safety-and-health/workplace-violence-prevention) për të mbështetur një mjedis pune ku situatat e dhunshme ose potencialisht të dhunshme trajtohen në mënyrë efektive, me fokus te parandalimi. Të gjithë punonjësit do të kërkohet të marrin pjesë në trajnimin vjetor si pjesë e këtij programi.

8- Mundësi të Barabarta Punësimi (EEO)

DOE u vë në dispozicion të gjithë punonjësve politika të ndryshme për Mundësi të Barabarta Punësimi (EEO) dhe burime të lidhura me to. Këto burime promovojnë një ndjenjë përkatësie, mirëqenieje, komuniteti, respekti dhe sigurie për stafin, duke përfshirë:

- [Rregulloren gjithëpërfshirëse të Diversitetit dhe Përfshirjes të DOE;](#)
- [Rregullorja e Mos Diskriminimit dhe Rregullorja e Kancelarit A-830;](#)
- [Diversiteti i Furnitorëve dhe Ndërmarrjet në Pronësi të Pakicave/Gruas \(Supplier Diversity and Minority/Women-owned Business Enterprises – MWBEs\);](#)
- [HR lidhu: Akomodime të Arsyeshme;](#)
- [Grupet e Burimeve për Punonjësit \(Employee Resource Groups – ERGs\); dhe](#)
- [Programi i Ndhmës për Punonjësit i NYC \(NYC Employee Assistance Program\);](#)
- [Zyra e Akomodimeve për Aftësi të Kufizuara \(Office of Disability Accommodations\);](#)
- [Rregullorja e EEO e Qytetit të Nju Jorkut](#)
- [Politika e Diversitetit dhe Përfshirjes](#)
- [Politika e Mosdiskriminimit](#)
- [Rregullorja e Kancelarit A-830](#)
- [Diversiteti i Furnitorëve dhe Ndërmarrjet në Pronësi të Pakicave/Gruas \(MWBE\)](#)
- [HR lidhu: Akomodime të Arsyeshme](#)
- [Grupet e Burimeve për Punonjësit \(ERG\)](#)
- [Programi i Ndhmës për Punonjësit i NYC-së](#)
- [Zyra e Akomodimeve për Aftësi të Kufizuara \(Office of Disability Accommodations\)](#)

9- Plani i Mësimdhënies në Distançë gjatë Emergjencave

DOE ka vendosur rregullore dhe procedura për të siguruar që pajisjet kompjuterike do të vihen në dispozicion të nxënësve ose do të ofrohen mënyra të tjera përmes të cilave nxënësit do të marrin pjesë në mësim sinkron. Rregullore dhe procedura shtesë janë vendosur për të siguruar që nxënësit që marrin mësim në distancë gjatë kushteve të emergjencës të kenë qasje në lidhje interneti.

a) Qasja në pajisje

DOE ka procedura për të ndjekur shpërndarjen e pajisjeve për nxënësit. Kjo përfshin qasjen e nxënësve në pajisjet personale, si dhe pajisjet e shpërndara nga DOE, për të siguruar që të gjithë nxënësit që kanë nevojë për pajisje për të ndjekur mësimin në distancë, të mund të marrin një. Shkollat do të japin përparësi në shpërndarjen e pajisjeve të prokuruar në mënyrë qendrore për nxënësit që kanë nevojë. Kur furnizimi i tyre me pajisje të financuara në mënyrë qendrore të përfundojë, shkollat mund të shpërndajnë pajisje të blera nga vetë shkolla për nxënësit. Shkollat gjithashtu mund të koordinojnë një hua afatshkurtër të një pajisjeje për një nxënës në parashikim të një dite mësimi në distancë. ~~Nëse është e nevojshme, shkollat mund të blejnë pajisje shtesë me fondet e tyre përmes kontratave ekzistuese të DOE~~ Shkollat duhet të rishikojnë çdo vit nevojat për pajisjet, inventarin, gjendjen dhe funksionalitetin e tyre, si dhe të ndajnë fonde sipas nevojës për të rimbushur ose zëvendësuar pajisjet, në mënyrë që nxënësit të kenë akses të vazhdueshëm në teknologjinë funksionale.

~~Që nga viti 2020, rreth 550,000 iPad dhe 200,000 Chromebook janë blerë dhe shpërndarë për nxënësit dhe shkollat për përdorim nga nxënësit. DOE do të vazhdojë të ofrojë pajisje për nxënësit që kanë nevojë për to.~~

b) Qasja në internet

DOE përdor përgjigjet nga Pyetësi i Barazisë Digjitale për Familjet për të ndihmuar shkollat të identifikojnë familjet që nuk kanë qasje në Wi-Fi në shtëpi.

~~DOE~~ Në masën e mundshme, shkollat do të mbështesin mbështesin nxënësit dhe familjet për të pasur qasje në internet në shtëpi.

Të gjithë nxënësit që përdorin pajisje LTE të blera në mënyrë qendrore janë kaluar tashmë në shërbime interneti wireless. Shkollave u është dhënë udhëzim të mbështesin familjet për të marrë informacion mbi mënyrat e aksesit në një nga opsionet e shumta pa kosto ose me kosto të ulët për qasje në Wi-Fi.

Faqja e internetit e DOE përmbledh opsionet e ndryshme falas ose me kosto të ulët përmes të cilave mund të sigurohet shërbim interneti wireless. Përveç kësaj, mbi 200 strehimore për të pastrehët në gjithë Qytetin e Nju Jorkut kanë shërbim pa tel dhe Big Apple Connect siguron që banorët e NYCHA të kenë qasje në internet falas, të shpejtë, të besueshëm dhe të sigurt.

Shkollave do t'u jepet udhëzim ta ndajnë këtë informacion me familjet dhe t'i ndihmojnë ata të regjistrohen në opsionin që u përshtatet më shumë rrethanave të tyre. Ne parashikojmë që familjet pa qasje në Wi-Fi në shtëpi do të jenë në gjendje të sigurojnë Wi-Fi falas ose me zbritje përmes njërit prej këtyre opsioneve.

Nëse këto opsione nuk janë të mundshme, shkollat mund të blejnë dhe të ofrojnë një pikë aksesi wireless (hotspot) me LTE ose pajisje me shërbim LTE përmes kontratave ekzistuese për familjet në nevojë.

c) Politikat dhe procedurat

Politikat dhe procedurat duhet të përfshijnë:

- Pritshmëritë për stafin e shkollës lidhen me përqindjen e kohës së kaluar në mësim sinkron dhe asinkron për nxënësit gjatë ditëve të mësimi në distancë nën kushte emergjente, me pritshmërinë që mësimi asinkron të jetë plotësues ndaj mësimi sinkron.
- Mësuesit dhe ofruesit e shërbimeve të lidhura [me shkollën](#) janë të detyruar të krijojnë klasa digjitale në një platformë të miratuar nga DOE dhe të jenë të lidhur me të gjithë nxënësit e caktuar. Në rast të mbylljes së një shkolle, mësuesit e bazuar në shkollë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve të detyruara duhet të kalojnë në mësim në distancë sinkron përmes klasës digjitale. [Punonjësit Për më shumë informacion, punonjësit](#) mund të shqyrtojnë Udhëzuesin [aktual të](#) Rregullores së Punës për Klasën Digjitale (Labor Policy Guidance for Digital Classroom) të disponueshëm në faqen e brendshme të internetit të DOE.
- Përshkrimi i mënyrës se si do të zhvillohet mësimi për ata nxënës për të cilët mësimi në distancë përmes teknologjisë digjitale nuk është i disponueshëm ose i përshtatshëm. Drejtuesit e shkollës janë përgjegjës për të siguruar që ekziston një sistem që mbështet nxënësit në përdorimin e teknologjisë së tyre në shtëpi për t'u lidhur me mësimin. Për nxënësit për të cilët mësimi në distancë përmes teknologjisë digjitale nuk është i përshtatshëm, mësuesit pritet të dërgojnë në shtëpi materiale të njohura dhe të qasshme për nxënësit si pako pune konkrete, materiale ndihmëse, libra, etj. Këto materiale mund të përdoren në mënyrë asinkrone nga nxënësit dhe kujdestarët e tyre. Shkollat duhet të marrin në konsideratë ndarjen periodike të aktiviteteve dhe materialeve në pika të ndryshme të vitit shkollor në parashikim të ditëve të mundshme të mësimi në distancë. Pikat teknologjike të shkollës do të mbajnë një linjë të hapur komunikimi me familjet për t'i ndihmuar ato sipas nevojës me çështje të mundshme teknologjike.
- Një përshkrim i mënyrës se si arsimit special dhe shërbimet e lidhura do t'u ofrohen nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nxënësve parashkollorë me aftësi të kufizuara, kur është e zbatueshme, në përputhje me Programet e Arsimit të Personalizuar (Individualized Education Programs – IEPs) të tyre, për të siguruar ofrimin e vazhdueshëm të një arsimit publik të përshtatshëm dhe falas. ~~Mësuesit dhe ofruesit e shërbimeve të lidhura pritet të kalojnë në mësim sinkron në distancë në rast të një mbylljeje shkolle. Punonjësit mund të shqyrtojnë Udhëzuesin aktual të Rregullores së Punës për Klasën Digjitale (Labor Policy Guidance for Digital Classroom) të disponueshëm në faqen e brendshme të internetit të DOE.~~ Në përputhje me IEP-të e tyre, arsimit special dhe shërbimet e lidhura do t'u ofrohen nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nxënësve parashkollorë gjatë mësimi në distancë përmes një kombinimi të mundësive për të mësuar sinkron, seancave individuale mësimore për të ushtruar aftësitë e përcaktuara nga IEP, strategjive dhe detyrave mësimore për t'u angazhuar nga shtëpia. Ofruesit e shërbimeve të lidhura pritet të mbajnë oraret e shërbimeve me nxënësit përmes seancave në distancë sa më shumë që të jetë e mundur. Çdo terapist i terapisë profesionale ~~(OT)~~, terapisë fizike ~~(PT)~~ dhe terapisë së të folurit duhet të marrë pëlqimin e prindit çdo vit për të ofruar shërbime të lidhura në distancë për një nxënës. Qëllimet e IEP trajtohen në çdo seancë të shërbimeve të lidhura në distancë. Nëse mësimi në distancë nevojitet për një periudhë të zgjatur, ofruesit e shërbimeve të lidhura do të mbeten të qasshëm dhe do të komunikojnë me familjet dhe nxënësit përmes një platforme komunikimi të miratuar, në mënyrë të vazhdueshme.
- Në rastin e një dite shkollore në distancë, shkollat do të sigurojnë që nxënësit të kenë qasje në pajisjet e teknologjisë ndihmëse, siç përcaktohet në [Programet e Arsimit të Personalizuar \(Individualized Education Programs — IEPs\) ose Planet 504. IEP-të ose planet 504.](#) Kjo përfshin sistemet e Komunikimit Augmentativ dhe Alternativ (Augmentative and Alternative Communication – AAC) dhe mjetet e tjera të Teknologjisë Ndihmëse (Assistive Technology – AT). Për të mbështetur përdorimin efektiv të këtyre teknologjive gjatë të mësuarit sinkron, Ekipi Qendror i Teknologjisë Ndihmëse (Central AT Team) do të ofrojë trajnim në distancë dhe asistencë teknike. Të gjitha pajisjet AAC dhe AT të caktuara nga Ekipi

Qendror i Teknologjisë Ndhmëse menaxhohen përmes sistemit të centralizuar të menaxhimit të pajisjeve të [NYCPSDOE](#), për të siguruar mbikëqyrje dhe funksionalitet të duhur. ~~Për distriktet shkollore që marrin ndihmë bazë për arsimin (foundation aid), numri~~ [Numri](#) i vlerësuar i orëve mësimore që ~~distrikti shkollor~~ [DOE](#) synon të ~~kërkojë deklarojë~~ për qëllime të ~~mbështetjes ndihmës~~ shtetërore për çdo ditë të kaluar në mësim në distancë për shkak të kushteve të ~~emergjencës, sipas seksionit 175.5 të këtij Kapitulli.~~ [emergjente, në përputhje me ligjin shtetëror.](#) Numri i orëve të mësimin në distancë do të pasqyrojë numrin e orëve të parashikuara për mësimin në shkollë. Për nxënësit në kopshtin me kohë të plotë dhe në klasat një deri në gjashtë, DOE synon të kërkojë 5 orë në ditë, dhe për nxënësit në klasat 7–12, DOE synon të kërkojë 5.5 orë në ditë.

10- Temperaturat ~~Maksimale~~ [maksimale](#) në ~~Ndërtesat dhe Objektet Shkollore~~ [ndërtesat shkollore](#)

~~Ligji i Arsimit i Shtetit të Nju Jorkut Seksioni 409-N~~ [Ligji i Arsimit i Shtetit të Nju Jorkut Seksioni 409-N](#) (që hyn në fuqi më 1 shtator 2025), vendos rregulloret për temperaturat maksimale në ndërtesat dhe objektet shkollore. Shkollat do të jenë të detyruara të ndërmarrin veprime për të lehtësuar parehatinë e shkaktuar nga nxehtësia dhe për të larguar nxënësit dhe stafin nga hapësirat e përdorura, kur është e mundur. Rregullorja e plotë do të përfshihet në të gjitha Planet e Sigurisë së Ndërtesave Shkollore dhe Administrative (School and Administrative Building Safety Plans) për t'u zbatuar siç duhet nga drejtuesit e ndërtesave. ~~Përmbledhja e planit është si vijon:~~

[Përmbledhja e planit është si vijon:](#)

[a\) Përkufizimet](#)

1. Kushtet e Nxehtësisë Ekstreme: Ditët kur hapësirat arsimore dhe të shërbimeve mbështetëse arrijnë 82°F e lart.
2. Hapësirat e Shërbimeve Mbështetëse: Përfshin zyra, biblioteka, palestra, mensa (përjashtuar zonat e kuzhinës të përdorura për përgatitjen e ushqimit).
3. Matja e Temperaturës: Bëhet në një vend të hijesuar, tre këmbë mbi dysheme, pranë qendrës së dhomës.

[b\) Procedurat për Zbutjen e Nxehtësisë \(82°F ose më shumë\)](#)

Kur temperaturat e brendshme arrijnë 82°F, shkollat duhet të zbatojnë masat e mëposhtme për të lehtësuar parehatinë nga nxehtësia:

- Fikja e dritave të sipërme kur është e mundur, ulja e perdeve/rojave për të bllokuar rrezet direkte të diellit, përdorimi i ventilatorëve për të rritur qarkullimin e ajrit, hapja e dritareve dhe dyerve (kur është e sigurt), fikja e pajisjeve elektronike të papërdorura që prodhojnë nxehtësi, sigurimi i pushimeve shtesë me ujë për nxënësit dhe stafin, rregullimi i niveleve të aktivitetit fizik (p.sh., kufizimi i aktiviteteve të lodhshme në palestra).

[c\) Plani i Zhvendosjes ose Largimit të Parakohshëm \(Relocation or Dismissal Plan\) \(88°F ose më shumë\)](#)

Kur temperaturat e brendshme arrijnë 88°F, drejtuesit e ndërtesave duhet të punojnë me ekipet e tyre të mirëmbajtjes për të zbatuar masat e përshtatshme të zbutjes, të cilat mund të përfshijnë (por nuk kufizohen vetëm në): vlerësimin e masave të disponueshme për ftohje, zhvendosjen e stafit dhe nxënësve në hapësira më të freskëta, ose modifikimin e orarit të punës dhe të mësimin.

Drejtuesit e shkollave dhe ndërtesave administrative duhet të përdorin protokollet e komunikimit për të njoftuar stafin dhe nxënësit kur temperaturat arrijnë 88°F. Nëse ndodh largim i parakohshëm ose zhvendosje, drejtuesit e shkollës duhet të njoftojnë prindërit përmes telefonatave të automatizuara, emaileve ose

njoftimeve të distriktit. Nuk lejohet asnjë rregullim i ditës shkollore ose lirimi i parakohshëm pa miratimin e Kancelarit.

III-d) Trajnimi & Zbatueshmëria

- Trajnimi i stafit: Shkollat duhet të rishikojnë çdo vit protokollet e reagimit ndaj nxehtësisë.
- Monitorimi i temperaturës: Inxhinieri kujdestar i shkollës do të kontrollojë temperaturat në zonat me rrezik të lartë gjatë paralajmërimeve për nxehtësi dhe do të regjistrojë të gjitha ankesat dhe masat e zbutjes në Bazën e të Dhënave DSF HVAC Ventilation.
- Raportimi: Shkollat gjithashtu duhet të dokumentojnë dhe raportojnë incidentet e lidhura me nxehtësinë në OORS dhe duhet të informojnë zyrën e distriktit, Përfaqësuesin e EOC të Superintendentit (Superintendent's EOC Designee), dhe/ose EOC në 718-233-8515, ose me email në EOC@schools.nyc.gov

IV-e) Rishikimi & Përditësimet

Kjo rregullore do të rishikohet çdo vit dhe do të përditësohet sipas nevojës për të pasqyruar praktikat më të mira dhe ndryshimet rregullatore.

11- Rregullorja për celularët dhe pajisjet elektronike

Përmbledhje

Duke filluar nga viti shkollor 2025-26, në ~~Në~~ përputhje me [Ligjin e Shtetit të Nju Jorkut \(New York State Law\), Shkollat Publike të Nju Jorkut \(New York City Public Schools — NYCPS\)](#) po përditësojnë rregulloren e tyre lidhur me ~~ligjin shtetëror, DOE ka një politikë mbi~~ përdorimin e pajisjeve ~~personale~~ elektronike ~~me qasje personale të~~ [aktivizuara](#) në internet, [duke përfshirë celularët telefonat celularë](#), në shkollë. Ky ndryshim mbështet synimin e Shtetit për të krijuar shkolla pa shpërqendrim dhe synon të sigurojë mjedise të sigurta dhe të përqendruara në të mësuarit në të gjitha shkollat e [NYCPSDOE](#). Sipas ~~rregullores politikës~~ së përditësuar, Rregullorja e Kancelarit A-413, nxënësve nuk u lejohet të përdorin pajisje personale elektronike me qasje në internet gjatë gjithë ditës shkollore, duke përfshirë si kohën mësimore ashtu edhe kohën jo-mësimore, brenda ambienteve të shkollës (hapësirat e brendshme dhe të jashtme brenda territorit të shkollës). Kjo përfshin pajisje si celularë, laptopë, tabletë dhe sisteme portative për muzikë dhe argëtim. Rregullorja nuk kufizon përdorimin e pajisjeve të lëshuara nga shkolla, si laptopët dhe Chromebooks, për qëllimin e tyre të parashikuar. Nxënësit do të vazhdojnë të jenë në gjendje të përdorin pajisjet e tyre të ~~dhëna nga NYCPS për detyra në klasë dhe punë të tjera brenda shkollës. Nxënësve mund t'u lejohet të përdorin pajisjet e tyre personale elektronike për~~ [aktivitete arsimore vetëm kur autorizohen nga drejtori ose përfaqësuesi i tij; ju lutemi, konsultohuni me rregulloren e shkollës tuaj për pajisjet për detaje specifike lëshuara nga DOE për detyrat e klasës dhe detyra të tjera në shkollë.](#)

Çdo shkollë duhet të zhvillojë rregulloren e saj të shkruar lidhur me përdorimin e pajisjeve elektronike, në përputhje me Rregulloren e Kancelarit (Chancellor's Regulation) ~~},~~ [A-413](#). Këto rregulla do t'u komunikohen prindërve dhe nxënësve në fillim të vitit shkollor ose në momentin e regjistrimit. Drejtuesit e shkollave që ndajnë të njëjtin kampus do të koordinojë zhvillimin e rregulloreve të përbashkëta që do të ndiqen nga të gjitha shkollat në atë kampus. Prindërit duhet t'i shqyrtojnë me kujdes këto rregullore dhe të sigurojnë që fëmija i tyre i kupton rregullat dhe procedurat specifike që lidhen me pajisjet elektronike personale në shkollën e tyre, përfshirë se ku dhe si duhet të ruhen pajisjet e tyre në mënyrë të sigurt.

Përjashtimet:

- Nxënësve duhet t'u lejohet qasja në një pajisje të lidhur me internetin, nëse kërkohet nga një [Program i Arsimit të Personalizuar \(Individualized Education Program — IEP\)](#) ose [nga një Planplan](#) 504.
- ~~Vetëm kur~~ [Kur](#) autorizohet nga [drejtuesit udhëheqja](#) e shkollës, pajisjet mund të përdoren:

- ~~Për qëllime arsimore, sipas udhëzimit të mësuesve dhe me autorizimin e drejtuesve të shkollës. Kur autorizohet nga drejtori/i emëruari për një qëllim specifik arsimor.~~
- Nga nxënës me kushte mjekësore që kërkojnë përdorimin e pajisjeve elektronike për t'i monitoruar, si p.sh. monitorët e glukozës për diabetin. Në ~~këtë rast këto raste~~, prindërit duhet të informojnë shkollën dhe të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për të siguruar autorizimin dhe përdorimin e duhur.
- ~~Për shërbime përkthimi, për të ndihmuar nxënësit që kanë nevojë për mbështetje gjuhësore që nuk ofrohet aktualisht nga shkolla e tyre. Për shërbimet e përkthimit dhe interpretimit, nëse nuk janë të disponueshme mënyra të tjera për të tilla shërbime.~~
- Nga nxënës kujdestarë, në raste të veçanta. Një psikolog shkollor, punonjës social shkollor ose këshilltar shkollor do të shqyrtojë dhe do të vendosë nëse mund të jepen përjashtime për një nxënës kujdestar që është rregullisht përgjegjës për kujdesin dhe mirëqenien e një anëtarit të familjes.
- Në situata emergjente individuale, kur prindi ka njoftuar drejtuesit e shkollës për natyrën specifike të emergjencës.
- Kur kërkohet ndryshe nga ligji. Kjo përfshin situata kur ligjet federale, shtetërore ose vendore e detyrojnë përdorimin e këtyre pajisjeve për qëllime specifike.

Menaxhimi i Emergjencave:

Shkollat duhet të ofrojnë të paktën një mënyrë që prindërit të kontaktojnë fëmijët e tyre gjatë emergjencave, përfshirë një numër telefoni direkt të shkollës. Prindërit duhet të njihen me këto mënyra kontakti dhe të sigurohen që kanë informacionin e nevojshëm të kontaktit për shkollën e tyre. Në rast emergjence në shkollë, drejtuesit e shkollës do të kontaktojnë drejtpërdrejt familjet e nxënësve.

Shkeljet e Rregullores:

Nëse një nxënës përdor pajisjen e tij pa leje gjatë ditës shkollore, ai/ajo mund t'i nënshtrohet disiplinës progresive në përputhje me rregulloret e shkollës dhe Kodin e Disiplinës të [NYCPSDOE](#) (NYCPS Discipline Code). Kjo do të thotë që shkolla do të përdorë një sërë ndërhyrjesh dhe pasojash të rritura gradualisht për të adresuar sjelljen, në bazë të natyrës dhe shpeshtësisë së shkeljes. Shembuj ndërhyrjesh përfshijnë konferenca me prindin e nxënësit ose, nëse sjellja është mjaftueshëm shpërqendruese, largimin nga klasa. Nxënësit nuk mund të pezullohen vetëm për shkak të përdorimit të pajisjeve personale elektronike me qasje në internet në shkelje të rregullores së shkollës.

12- Ligji i Desha-s: Procedurat për arrest kardiak dhe pajisjet e defibrilatorit të jashtëm automatik (AED) dhe planet e reagimit të ndërtesës.

Përmbledhje

~~Duke filluar nga viti shkollor 2025-26, në përputhje me Ligjin e Shtetit të Nju Jorkut (New York State Law) (Ligji i Desha-s — Planet e Reagimit ndaj Arrestimeve Kardiake — Desha's Law: Cardiac Arrest Emergency Response Plans), të~~ gjitha distriktet shkollore duhet të përmbushin kërkesat e ~~ndryshimeve të fundit në ligjin e shtetit që lidhen ligjit shtetëror në lidhje~~ me procedurat e arrestit kardiak dhe pajisjet e defibrilatorit të jashtëm automatik (AED). Këto kërkesa përfshijnë që politikat dhe procedurat për reagimin ndaj arrestimit të papritur kardiak të përfshihen në planet e reagimit emergjent në nivel ndërtese, si dhe që informacioni mbi pajisjet AED, mirëmbajtjen e AED, shenjat orientuese dhe trajnimin e sigurisë së shkollës për planet e reagimit emergjent kardiak të shfaqen në planet e sigurisë shkollore në nivel distrikti. Këto detaje aktualisht përfshihen në të gjitha Planet e Sigurisë së Ndërtesave Shkollore (School Building Safety Plans) dhe rishikohen çdo vit nga Komiteti i Sigurisë së Shkollës (School Safety Committee) në secilën ndërtesë.

Kërkesat, siç përcaktohen tani në ndryshimet e Ligjit të Arsimit § 2801-a(2)(n), janë:

- Përdorimi i personelit të përshtatshëm për t'iu përgjigjur incidenteve që përfshijnë çdo individ që përjeton arrest kardiak të papritur ose emergjencë tjetër kërcënuese për jetën në çdo objekt shkolle në pronësi ose të operuar nga shkolla, ose në një vend të një aktiviteti të sponsorizuar nga shkolla, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në të gjitha programet sportive.
 - Aktualisht, në të gjitha ndërtesat shkollore, ekipet shkollore të trajnuara në CPR/AED përfshijnë:
 - 2 anëtarë të stafit të DOE (të paktën, dhe njëri duhet të jetë pjesë e Ekipit të Reagimit të Ndërtesës)
 - Të gjithë trajnerët e Public School Athletic League (kur është e aplikueshme)
 - Infermieri/ja e Shkollës
 - Të gjithë Agjentët e Sigurisë së Shkollës
 - Pjesëtarë të përzgjedhur të stafit të punësuar nga programet pas-shkollore.
 - Procedura specifike për incidentet që përfshijnë një individ që përjeton arrest kardiak të papritur ose një emergjencë tjetër kërcënuese për jetën gjatë pjesëmarrjes në një stërvitje ose aktivitet sportiv brenda ambienteve të shkollës, të përshtatura sipas vendit ku zhvillohet aktiviteti.
 - Planet e reagimit CODE BLUE (KODI BLU) janë të detajuara në secilin Plan të Sigurisë së Ndërtesës dhe ushtrimet zhvillohen në çdo ndërtesë.
 - Integrimi i elementeve bazë të pranuar kombëtarisht dhe të bazuara në evidencë, si ato të rekomanduara nga Shoqata Amerikane e Zemrës (American Heart Association).
 - Trajtohet nga i vetmi ofrues i kontraktuar përgjegjës për trajnimin e gjithë stafit shkollor të identifikuar si reagues CPR/AED. Kjo nismë menaxhohet nga Zyra e Shëndetit të Shkollës e NYCDOE (NYCDOE Office of School Health).
 - Merr parasysh mënyrën më të mirë për të integruar planet e reagimit emergjent kardiak në protokollet e reagimit të Shërbimeve Emergjente Mjekësore të komunitetit (Emergency Medical Services – EMS).
 - Të gjitha incidentet e arrestimit kardiak kërkojnë njoftim në 911 përmes një telefonate, si dhe nga Agjenti i Sigurisë së Shkollës i NYPD, i cili nis një kod emergjent në Radion Zyrtare Dykahëshe të NYPD (NYPD Two-Way Radio), gjë që do të kërkojë përgjigjen e FDNY/EMS.

Dokumentet kryesore të mëposhtme janë pjesë e Kodit të Sjelljes dhe Planit të Sigurisë së Shkollave në Të Gjithë Distriktin (District-Wide School Safety Plan) të DOE.

Rregullorja e Kancelarit A-411, De-Eskalimi/ Ndërhyrja në Krizat e Sjelljes dhe Kontaktimi i 911

Rregullorja e Kancelarit A-412, Siguria në Shkollë

Rregullorja e Kancelarit A-413, Telefonat Celularë dhe Pajisje të Tjera Elektronike në Shkollë

Rregullorja e Kancelarit A-414 Planet e Sigurisë

Rregullorja e Kancelarit A-415 Sistemi i Njoftimit të Emergjencës i Departamentit të Arsimit

Rregullorja e Kancelarit A-418 Njoftimi për Abuzuesit Seksualë

Rregullorja e Kancelarit A-420 Ndëshkimi Fizik

Rregullorja e Kancelarit A-421 Abuzimi Verbal

Rregullorja e Kancelarit A-432 Kërkimi dhe Sekuestrimi

Rregullorja e Kancelarit A-443 Procedurat Disiplinore për Nxënësit

Rregullorja e Kancelarit A-449 Planet e Sigurisë

Rregullorja e Kancelarit A-450 Procedurat e Transferit të Detyruar

Rregullorja e Kancelarit A-750 Abuzimi ndaj Fëmijëve

Rregullorja e Kancelarit A-755, Parandalimi/ Ndërhyrja në Vetëvrasje

Rregullorja e Kancelarit A-830, Paraqitja e Ankesave të Brendshme për Diskriminim/Ngacim të Paligjshëm

Rregullorja e Kancelarit A-831, Ngacimi Seksual nga Bashkëmoshatarët

Rregullorja e Kancelarit A-832, Ngacim, Frikësim dhe/ose Bullizëm nga Nxënës ndaj Nxënësve mbi Bazën e Paragjykit

Respekt për të Gjithë: Parandalimi dhe Trajtimi i Diskriminimit, Ngacimit Seksual dhe të Tjerëve, Frikësimit dhe Bullizmit Nxënës-nxënës

Marrëveshja e Rishikuar (MOU) midis DOE, NYPD dhe Qytetit të Nju Jorkut

Pritshmëritë e Sjelljes në Të Gjithë Qytetin për të Mbështetur të Mësuarin e Nxënësve (Kodi i Disiplinës K-5)

Pritshmëritë e Sjelljes në Të Gjithë Qytetin për të Mbështetur të Mësuarin e Nxënësve (Kodi i Disiplinës 6-12)

Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Prindërve

Udhëzues për Prindërit për Sigurinë në Shkollë dhe Përgatitjen për Emergjencë Politike e Përdorimit të

Pranueshëm të Internetit dhe Sigurisë

Udhëzime për Rrjetet Sociale për Nxënësit 12 vjeç dhe më të Vegjël

Udhëzime për Rrjetet Sociale për Nxënësit mbi 13 vjeç

ACS – Manuali i Prindërve (nyc.gov)